

V E N D I M
Nr.538, datë 21.8.1998

**PËR RIORGANIZIMIN E MISIONIT DIPLOMATIK ME QENDËR NË BRUKSEL DHE
HAPJEN E MISIONIT TË PËRHERSHËM PRANË BASHKIMIT EUROPIAN**

Në mbështetje të nenit 5 të ligjit nr.8370, datë 9.7.1998 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Riorganizimin e misionit diplomatik me qendër në Bruksel, i cili mbulon marrëdhëniet dypalëshe dhe ato me Bashkimin European.

2. Miratimin e hapjes së ambasadës së Republikës së Shqipërisë pranë Mbretërisë së Belgjikës dhe Dukatit të Madh të Luksemburgut, me përfaqësim në nivel ambasadori me qendër në Bruksel. Kjo ambasadë të mbulojë marrëdhëniet dypalëshe me këto shtete.

3. Miratimin e hapjes së misionit të përherëshëm të Republikës së Shqipërisë pranë Bashkimit European, me përfaqësim në nivel ambasadori, me qendër në Bruksel. Ky mision të mbulojë marrëdhëniet me këtë organizëm.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano